**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

***Qeveria – Vlada – Government***

***Ministria e Drejtësisë -Ministarstvo Pravde– Ministry of Justice***

# PROJEKTLIGJI PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE

# DRAFT LAW ON PROTECTION OF WHISTLEBLOWERS

# NACRT ZAKONA O ZAŠTITI UZBUNJIVAČA

| | | |
|---|---|---|
| **Kuvendi i Republikës së Kosovës,**<br><br>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,<br><br>Miraton:<br><br>**LIGJ PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE**<br><br>**KAPITULLI I**<br>**DISPOZITAT THEMELORE**<br><br>**Neni 1**<br>**Qëllimi**<br><br>Qëllimi i këtij ligji është mundësimi i sinjalizimit të shkeljeve në sektorin publik dhe privat dhe mbrojtja e sinjalizuesve.<br><br>**Neni 2**<br>**Fushëveprimi**<br><br>Ky ligj përcakton rregullat për sinjalizimin, procedurën e sinjalizimit, të drejtat e sinjalizuesve dhe detyrimet e institucioneve publike dhe subjekteve private në lidhje me sinjalizimin. | **The Assembly of the Republic of Kosovo,**<br><br>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,<br><br>Approves:<br><br>**LAW ON PROTECTION OF WHISTLEBLOWERS**<br><br>**CHAPTER I**<br>**GENERAL PROVISIONS**<br><br>**Article 1**<br>**Purpose**<br><br>The purpose of this law is to enable the whistleblowing of violations in the public and private sector and the protection of whistleblowers.<br><br>**Article 2**<br>**Scope**<br><br>This law sets out the rules on whistleblowing, whistleblowing procedure, rights and protection of whistleblowers and the obligations of public institutions and private entities regarding whistleblowing. | **Skupština Republike Kosova,**<br><br>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo,<br><br>Usvaja:<br><br>**ZAKON O ZAŠTITI UZBUNJIVAČA**<br><br>**GLAVA I**<br>**OPŠTE ODREDBE**<br><br>**Član 1.**<br>**Svrha**<br><br>Svrha ovog zakona je da omogući uzbunjivanje kod kršenja prava u javnom i privatnom sektoru i zaštitu uzbunjivača.<br><br>**Član 2.**<br>**Delokrug važenja**<br><br>Ovaj zakon propisuje pravila za uzbunjivanje, postupak uzbunjivanja, prava i zaštitu uzbunjivača i obaveze javnih ustanova i privatnih pravnih lica u vezi sa uzbunjivanjem. |

| Albanian | English | Serbian |
|---|---|---|
| **Neni 3**<br>**Përkufizimet** | **Article 3**<br>**Definitions** | **Član 3**<br>**Značenja izraza** |
| 1. Për qëllime të këtij Ligji, shprehjet e mëposhtme do të kenë këto kuptime: | 1. For purposes of this Law, the following terms have the following meanings: | 1. Za potrebe ovog Zakona, naredni izrazi imaju sledeća značenja: |
| 1.1. **Sinjalizues -** çdo person i cili raporton ose shpalos informacione për një kërcënim ose cenim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës në sektorin publik ose privat. | 1.1. **Whistleblower –** is any person who reports or discloses information on threat or damage to the public interest in the context of own employment relationship in the public or private sector. | 1.1. **Uzbunjivač-** svako lice koje prijavi ili objavi podatke o nekoj pretnji ili povredi javnog interesa u kontekstu svog radnog odnosa u javnom ili privatnom sektoru. |
| 1.2. **Raportim ose shpalosje në interes publik -** nënkupton raportimin ose shpalosjen e informacionit për veprimet dhe mosveprimet që paraqesin kërcënim ose cenim të interesit publik. | 1.2. **Public interest reporting or disclosure** – means reporting or disclosure of information on acts or omissions that pose a threat or damage to the public interest. | 1.2. **Prijava ili objavljivanje u javnom interesu -** označava prijavu ili objavljivanje informacija o nekom činjenju ili nečinjenju koje predstavlja pretnju javnom interesu. |
| 1.3. **Raportim -** nënkupton raportimin brenda institucionit publik apo subjektit privat ose tek autoriteti kompetent. | 1.3. **Reporting** – means reporting in the public institution or private entity or to the competent authority. | 1.3. **Prijava -** označava prijavljivanje unutar javne ustanove ili privatnog pravnog lica ili prijavu nadležnom organu. |
| 1.4. **Shpalosje -** nënkupton bërjen publike të informacionit. | 1.4.**Disclosure** – means making information public. | 1.4. **Objavljivanje –** označava obelodanjivanje informacije. |
| 1.5. **Person në kontekst të marrëdhënies së punës -** personi fizik i cili është apo ka qenë: | 1.5. **A person in the context of an employment relationship** – means a natural person who is or has been: | 1.5. **Lice u kontekstu radnog odnosa -** fizičko lice koje je ili koje je bilo: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.5.1. në marrëdhënie pune në një institucion publik ose subjekt privat pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës, kohëzgjatja ose pagesa; | 1.5.1 in employment relationship with a public institution or private entity, regardless of the nature of the relationship, its duration or payment; | 1.5.1.. u radnom odnosu u nekoj javnoj ustanovi ili privatnom pravnom licu nezavisno od vrste radnog odnosa, njegovog trajanja ili zarade; |
| 1.5.2. bashkëpunëtor i jashtëm ose i rastit, vullnetar, në praktikë profesionale ose trajnim; | 1.5.2. an external or occasional associate, volunteer, in professional internship or training relationship; | 1.5.2. spoljni ili privremeni saradnik, volonter, lice na stručnoj praksi ili na obuci; |
| 1.5.3. kandidat për punësim, aktivitete vullnetare, praktikë profesionale ose trajnim; | 1.5.3. a candidate for employment, volunteering activities, professional internship or training; | 1.5.3. kandidat za prijem u radni odnos, volonterski rad, stručnu praksu ili obuku; |
| 1.5.4.në marrëdhënie kontraktore punësh, shërbimesh ose lloje të tjera bashkëpunimi apo përdorim i shërbimeve të institucionit publik ose subjektit privat, përfshirë kontraktimin ose nënkontraktimin. | 1.5.4. in contractual relationship for works, services or other types of cooperation or use of services of public institution or private entity, including contracting or subcontracting. | 1.5.4. u ugovornom odnosu za izvođenje radova, pružanje usluga ili drugu vrstu saradnje ili korišćenja usluga javne ustanove ili privatnog pravnog lica, uključujući ugovaranje ili podugovaranje. |
| 1.6. **Punëdhënës -** nënkupton çdo institucion publik dhe subjekt privat që i përket ndonjërës prej kategorive të përkufizuara sipas nënparagrafit 1.5 të këtij paragrafi. | 1.6. **Employer** – means any public institution or private entity belonging to any of the categories defined in subparagraph 1.5 of this paragraph. | 1.6. **Poslodavac** - označava bilo koju javnu instituciju i privatno lice koje pripada bilo kojoj od kategorija definisanih u podstavu 1.5 ovog stava. |
| 1.7. **Autoritet kompetent** - Agjencia kundër Korrupsionit në lidhje me | 1.7. **Competent authority -** Anti-Corruption Agency with regard to | 1.7. **Nadležni organ** - Agencija za borbu protiv korupcije kod uzbunjivanja u |

| | | |
|---|---|---|
| sinjalizimin në sektorin publik, ndërsa rregullatorët sipas fushës në të cilën bëhet sinjalizimi në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat. | whistleblowing in the public sector and regulators according to the field where whistleblowing is made in the private sector. | javnom sektoru, odnosno regulatorno telo za oblast u kojoj se vrši uzbunjivanje kod uzbunjivanja u privatnom sektoru. |
| 1.8. **Institucion publik -** nënkupton organet, autoritetet dhe agjencitë publike në nivelin qendror dhe lokal që ushtrojnë kompetenca legjislative, ekzekutive, administrative, gjyqësore ose prokuroriale apo institucione të tjera publike të përcaktuara me ligj. | 1.8. **Public institution** – means public bodies, authorities and agencies at central and local level that exercise legislative, executive, administrative, judicial or prosecutorial powers or other public institutions established by law. | 1.8. **Javna ustanova -** označava javna tela, organe i agencije na centralnom i lokalnom nivou koji vrše zakonodavna, izvršna, upravna, sudska ili tužilačka ovlašćenja ili druge javne ustanove ustanovljenje zakonom. |
| 1.9. **Subjekt privat** – nënkupton personin juridik privat sipas Ligjit për shoqëritë tregtare, Ligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare dhe persona të tjerë juridikë të përcaktuar me ligj. | 1.9. **Private entity** – means any private legal person under the Law on Business Organisations, the Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations and other legal persons determined by law. | 1.9. **Privatno pravno lice** – označava privatno pravno lice u smislu zakona o privrednim društvima, zakona o slobodi udruživanja u nevladine organizacije i druga pravna lica utvrđena zakonom. |
| 1.10. **Zyrtar përgjegjës -** personi i caktuar nga institucioni publik apo subjekti privat për të pranuar dhe trajtuar sinjalizimin. | 1.10. **Responsible officer** – the person assigned by the public institution or the private entity to receive and handle whistleblowing. | 1.10. **Odgovorni službenik -** lice koje odredi javna ustanova ili privatno pravno lice za prijem i postupanje po uzbunjivanju. |
| 1.11. **Veprim i dëmshëm -** çdo veprim apo mosveprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë që cenon interesin e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që ndërlidhet me sinjalizimin. | 1.11. **Detrimental act –** is any direct or indirect action or omission that damages the legitimate interest of the whistleblower and is associated with whistleblowing. | 1.11. **Štetna radnja -** svako direktno ili indirektno činjenje ili nečinjenje kojim se povređuje zakoniti interes uzbunjivača i koje je u vezi sa uzbunjivanjem. |
| 1.12. **Person i lidhur me** | 1.12. **Person associated with the** | 1.12. **Lice povezano sa uzbunjivačem -** |

| | | |
|---|---|---|
| **sinjalizuesin** - personi i cili ndihmon sinjalizuesin ose mund të ofrojë prova të lidhura me sinjalizimin apo çdo person tjetër që mund të dëmtohet për shkak të lidhjes me sinjalizuesin. | **whistleblower** – is the person who assists the whistleblower or can provide evidence related to whistleblowing or any other person that may be harmed by being associated with the whistleblower. | lice koje pomaže uzbunjivaču ili može da pruži dokaze u vezi sa uzbunjivanjem, odnosno svako lice koje može da pretrpi štetu zbog veze sa uzbunjivačem. |
| 1.13. **E dhënë personale** - çdo informacion lidhur me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm siç përcaktohet me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. | 1.13. **Personal data** – means any information about an identified or identifiable natural person as defined by the applicable law on personal data protection. | 1.13. **Lični podaci** - svaka informacija koja se odnosi na fizičko lice čiji je identitet poznat ili se može utvrditi u smislu Zakona o zaštiti ličnih podataka. |
| 1.14. **Informacion i klasifikuar -** çdo informacion i klasifikuar siç përcaktohet me Ligjin për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë. | 1.14. **Classified information** – is any classified information as defined by the applicable law on classification of information and security clearances. | 1.14. **Tajne informacije -** svaka tajna informacija u smislu Zakona o klasifikaciji informacija i proveri njihove bezbednosti. |
| **KAPITULLI II<br>SINJALIZIMI, TË DREJTAT DHE MBROJTJA E SINJALIZUESVE** | **CHAPTER II<br>WHISTLEBLOWING, RIGHTS AND PROTECTION OF WHISTLEBLOWERS** | **GLAVA II<br>UZBUNJIVANJE, PRAVA I ZAŠTITA UZBUNJIVAČA** |
| **Neni 4<br>Raportimi dhe shpalosja e mbrojtur** | **Article 4<br>Protected reporting and disclosure** | **Član 4<br>Zaštićeno prijavljivanje i objavljivanje** |
| 1. Raportimi dhe shpalosja në interes publik është e mbrojtur kur bëhet për shkak se: | 1. Public interest reporting and disclosure is protected if it is related to the following: | 1. Prijavljivanje i objavljivanje u javnom interesu je zaštićeno kad se vrši zbog sledećeg: |
| 1.1. shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet; | 1.1. an offence has been, is being or is likely to be committed; | 1.1. povreda je učinjena, ili se čini, ili ima izgleda da bude učinjena; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.2. personi ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështoj të përmbush ndonjë detyrim ligjor; | 1.2. a person has failed, is failing or is likely to fail to comply with any legal obligation; | 1.2. lice nije izvršilo, ne izvršava, ili ima izgleda da neće da izvrši neku zakonsku obavezu; |
| 1.3. ka ndodhur, është duke ndodhur ose ka gjasa të ndodhë keqadministrimi i drejtësisë; | 1.3.a miscarriage of justice has occurred, is occurring or is likely to occur; | 1.3. dogodilo se, događa se, ili ima izgleda da će doći do pogrešnog vršenja funkcije pravde; |
| 1.4. shëndeti apo siguria e individit është rrezikuar, është duke u rrezikuar ose ka gjasa të rrezikohet; | 1.4. the health or safety of any individual has been, is being or is likely to be endangered; | 1.4. zdravlje ili bezbednost pojedinca su bili ili su i dalje ugroženi, ili ima izgleda da će postati ugroženi; |
| 1.5. mjedisi është dëmtuar, është duke u dëmtuar ose ka gjasa të dëmtohet; | 1.5. the environment has been, is being or is likely to be damaged; | 1.5. životna sredina je oštećena, trpi, ili ima izgleda da pretrpi oštećenje; |
| 1.6. ka pasur keqpërdorim të parave publike ose resurseve të një institucioni publik, kjo është duke ndodhur ose ka gjasa të ndodhë; | 1.6. an improper use of public money or resources of a public institution has occurred, is occurring or is likely to occur; | 1.6. dogodila se, događa se, ili ima izgleda da će doći do zloupotrebe javnih sredstava i resursa neke javne ustanove; |
| 1.7. një veprim apo mosveprim nga ose në emër të një institucioni publik është diskriminues, shtypës, kryhet nga pakujdesia ose përbën keqmenaxhim të rëndë; | 1.7. an act or omission by or on behalf of a public institution is discriminatory, oppressive, grossly negligent or constitutes serious mismanagement; or | 1.7. neko činjenje ili nečinjenje izvršeno od strane ili u ime neke javne ustanove je diskriminatorno, represivno, izvršeno iz nehata ili predstavlja tešku malverzaciju; |
| 1.8. informacioni që synon të tregojë ndonjë nga çështjet që bien në ndonjë nga nënparagrafët e mësipërm ka qenë, është ose ka gjasa të jetë fshehur ose shkatërruar. | 1.8. information tending to show any matter falling within any of the preceding subparagraphs has been, is being or is likely to be concealed or destroyed. | 1.8. podaci koji mogu da ukažu na neki od slučajeva iz prethodnih tačaka već su skriveni ili uništeni, ili je to u toku, ili ima izgleda da dođe do toga. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Raportimi apo shpalosja do të supozohet se është në interes publik, përveç nëse vërtetohet e kundërta. | 2. Reporting or disclosure is presumed to be in public interest unless the contrary is proven. | 2. Pretpostavlja se da su prijava ili objavljivanje u javnom interesu, osim ako se ne dokaže suprotno. |
| **Neni 5**<br>**Afati për raportim dhe shpalosje në interes publik** | **Article 5**<br>**Deadline for protected reporting and disclosure** | **Član 5**<br>**Rok za prijavu i objavljivanje u javnom interesu** |
| Raportimi apo shpalosja në interes publik bëhet jo më vonë se një (1) vit nga marrja e njoftimit për shkeljen konkrete. | Public interest reporting or disclosure shall be made no later than one (1) year from the receipt of notice of a specific violation. | Izveštavanje ili objavljivanje u javnom interesu obavlja se najkasnije u roku od jedne (1) godine od prijema obaveštenja o određenoj povredi. |
| **Neni 6**<br>**Ndalimi i pengimit të sinjalizimit** | **Article 6**<br>**Prohibition of preventing whistleblowing** | **Član 6.**<br>**Zabrana sprečavanja uzbunjivanja** |
| 1. Çdo veprim ose mosveprim që synon pengimin e raportimit apo shpalosjes në interes publik është i pavlefshëm. | 1. Any action or omission aimed at preventing public interest reporting or disclosure is null and void. | 1. Svako činjenje ili nečinjenje koje ima za cilj da spreči prijavu ili objavljivanje u javnom interesu je nevažeće. |
| 2. Çdo dispozitë në një marrëveshje është e pavlefshme nëse synon të: | 2. Any provision in an agreement is void in so far as it purports to: | 2. Svaka odredba nekog ugovora je nevažeća ako ima za cilj da: |
| 2.1. ndalojë ose kufizojë raportimin apo shpalosjen në interes publik; | 2.1. prohibit or restrict the making of public interest reporting or disclosure; | 2.1. zabrani ili ograniči prijavljivanje ili objavljivanje u javnom interesu; |
| 2.2. përjashtojë ose kufizojë zbatimin e ndonjë dispozite të këtij ligji; | 2.2. exclude or limit the operation of any provision of this Law; | 2.2. isključi ili ograniči primenu neke odredbe ovog zakona; |
| 2.3. pengojë një person për të filluar ndonjë procedurë në bazë të këtij ligji; | 2.3. preclude a person from bringing any proceedings under or by virtue of this Law, or; | 2.3. spreči nekoga da pokrene postupak na osnovu ovog zakona; |

| | | |
|---|---|---|
| 2.4. pengojë një person për të filluar ndonjë procedurë për shkelje të kontratës në lidhje me çdo gjë që bëhet si pasojë e raportimit apo shpalosjes së informatave në interes publik. | 2.4. preclude a person from bringing any proceedings for breach of contract in respect of anything done in consequence of the making of a reporting or disclosure of information in public interest. | 2.4. spreči nekoga da pokrene postupak zbog povrede ugovora u vezi sa bilo čim što je urađeno kao posledica prijave ili objavljivanja informacija u javnom interesu. |
| **Neni 7**<br>**Të drejtat e sinjalizuesit** | **Article 7**<br>**Rights of whistleblowers** | **Član 7**<br>**Prava uzbunjivača** |
| 1. Sinjalizuesi gëzon të drejtën e: | 1. A whistleblower has the right to: | 1. Uzbunjivač ima pravo na: |
| 1.1. mbrojtjes së identitetit të tij gjatë procesit të sinjalizimit; | 1.1 Protection of his/her identity during the whsitleblowing proces; | 1.1 zaštitu svog identiteta u toku postuaka uzbunjivanja; |
| 1.2. ruajtjen e fshehtësisë së burimit të informacionit të sinjalizuar; | 1.2 preservation of the confidentiality of the source of reported or disclosed information; | 1.2 čuvanje poverljivosti izvor informacije koja je predmet uzbunjivanja; |
| 1.3. mbrojtjes kundër veprimeve të dëmshme. | 1.3 protection against detrimental acts. | 1.3 zaštitu od štetne radnje. |
| 2. Të drejtat e sinjalizuesit garantohen sipas këtij ligji: | 2. The rights of whistleblowers are guaranteed under this law: | 2. Prava uzbunjivača garantovana su u smislu ovog zakona: |
| 2.1. gjatë kohëzgjatjes së procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit; | 2.1.during the duration of the administrative investigation procedure of whistleblowing; | 2.1. u toku trajanja upravnog istražnog postupka uzbunjivanja; |
| 2.2. pas përfundimit të procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, me qëllim të kryerjes normale të | 2.2. after completion of the administrative investigation procedure of whistleblowing, with the aim to normally | 2.2. posle završetka upravnog istražnog postupka uzbunjivanja, u cilju obavljanja redovnih radnih zadataka uzbunjivača u |

| | | |
|---|---|---|
| detyrave funksionale të sinjalizuesit në marrëdhënien e vet të punësimit; | perform the functional duties of the whistleblower at his/her employment relationship; | svom radnom odnosu; |
| 2.3. pas përfundimit të marrëdhënies së punës së sinjalizuesit me punëdhënësin e tij, kur nga rrethana të arsyeshme, sinjalizuesi ka kërkuar mbrojtjen sipas këtij ligji. | 2.3. after termination of the employment relationship of the whistleblower with his/her employer, when, by reasonable circumstances, the whistleblower has requested protection under this law. | 2.3. posle završetka radnog odnosa uzbunjivača kod svog poslodavca, kad je u opravdanim okolnostima uzbunjivač zatražio zaštitu na osnovu ovog zakona. |
| **Neni 8**<br>**Të drejtat e personit të lidhur me sinjalizimin** | **Article 8**<br>**Rights of person associated with whistleblowing** | **Član 8.**<br>**Prava lica povezanih sa uzbunjivačem** |
| 1. Personi i lidhur me sinjalizuesin gëzon të njëjtën mbrojtje si sinjalizuesi, nëse personi i tillë provon se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij për shkak të lidhjes së tij me sinjalizuesin. | 1. The person associated with the whistleblower enjoys the same protection as the whistleblower if such person proves that the detrimental act is taken against him/her due to his/her association with the whistleblower. | 1. Lice povezano sa uzbunjivačem uživa ista prava na zaštitu kao i uzbunjivač, ako to lice dokaže da je štetna radnja preduzeta protiv njega zbog njegove povezanosti sa uzbunjivačem. |
| 2. Personi që provon se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij për shkak se personi që ndërmerr veprimin e dëmshëm beson gabimisht se ai është sinjalizues ose person i lidhur me të gëzon të njëjtat të drejta dhe mbrojtje si sinjalizuesi. | 2. A person who proves that detrimental act is taken against him because the person who commits such detrimental act incorrectly believes that he is a whistleblower or a person associated with a whistleblower, enjoys the same rights and protection as the whistleblower. | 2. Lice koje dokaže da je štetna radnja preduzeta protiv njega zbog toga što je učinilac štetne radnje pogrešno verovao da je on uzbunjivač ili lice povezano sa tim licem, uživaju ista prava na zaštitu kao i uzbunjivač. |
| 3. Zyrtari përgjegjës gëzon të njëjtën mbrojtje ashtu si sinjalizuesi nëse provon se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër | 3. A responsible oficial enjoys the same protection as the whistleblower if he or she proves that detrimental act has been taken | 3. Odgovorni službenik uživa ista prava kao i uzbunjivač ako dokaže da je štetna radnja preduzeta protiv njega u vezi sa njegovim vršenjem službene dužnosti. |

| | | |
|---|---|---|
| tij në lidhje me kryerjen e detyrës zyrtare. | against him or her in the performance of official duty. | |
| **Neni 9**<br>**Mbrojtja e sinjalizuesve** | **Article 9**<br>**Protection of whistleblowers** | **Član 9.**<br>**Zaštita uzbunjivača** |
| 1. Sinjalizuesi ka të drejtën e mbrojtjes sipas këtij ligji, në rastet kur: | 1. A whistleblower has the right to protection under this Law in cases when: | 1. Uzbunjivač ima pravo na zaštitu na osnovu ovog zakona, u slučajevima kad: |
| 1.1. raporton ose shpalos informacion siç është përcaktuar me këtë ligj; | 1.1. he or she reports or discloses information as required under this law; | 1.1 prijavi ili objavi informacije koje su propisane ovim zakonom; |
| 1.2. me arsye beson se informacioni i raportuar apo i shpalosur është i vërtetë. | 1.2. he or she reasonably believes that the information reported or disclosed is true. | 1.2 osnovano veruje da je prijavljena ili objavljena informacija istinita. |
| 2.Sinjalizuesi nuk është i detyruar të provojë mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizuar. | 2. The whistleblower is not required to prove his or her good faith and authenticity of reported information. | 2. Uzbunjivač nije obavezan da dokazuje pouzdanost i istinitost informacije koja je predmet uzbunjivanja. |
| 3. Mbrojtja e garantuar për sinjalizuesin sipas këtij ligji nuk duhet të paragjykohet nëse kërcënimi apo cenimi i interesit publik i pretenduar nuk është materializuar. | 3. The protection to the whistleblower guaranteed under this law should not be prejudiced if the alleged threat or damage to the public interest has not been materialised. | 3.Zaštita uzbunjivača garantovana ovim zakonom ne treba da se uskrati ako se pretnja ili povreda javnog interesa nije ostvarila. |
| **Neni 10**<br>**Ndalimi i keqpërdorimit të sinjalizimit** | **Article 10**<br>**Prohibition of abuse of whistleblowing** | **Član 10.**<br>**Zabrana zloupotrebe uzbunjivanja** |
| 1. Mbrojtja e sinjalizuesit përjashtohet në rastet kur: | 1. The protection of whistleblowers is excluded under this law in the following cases: | 1. Zaštita uzbunjivača isključena je u slučajevima kad: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.1. sinjalizimi nuk është kryer për shkaqet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji; | 1.1. whistleblowing is not performed for the reasons set out in Article 4 of this Law; | 1.1. uzbunjivanje nije urađeno iz razloga navedenih u članu 4. ovog zakona; |
| 1.2. raportimi apo shpalosja kryhet në bazë të fakteve, informatave ose dokumenteve që sigurohen lidhur me dhënien e ndihmës juridike; | 1.2. reporting or disclosure is made on the basis of facts, information or documents provided in connection with the provision of legal aid; | 1.2. prijava ili objavljivanje vrše se na osnovu činjenica, informacija ili dokumenata dobijenih u vezi sa pružanjem pravne pomoći; |
| 1.3. sinjalizuesi raporton ose shpalos informacion që ai ka ose mund të ketë dijeni se është i rremë. | 1.3. the whistleblower reports or discloses information that he knows or must know is false. | 1.3. uzbunjivač prijavljuje ili objavljuje informaciju za koju zna ili može da sazna da su lažne. |
| **Neni 11**<br>**Konfidencialiteti** | **Article 11**<br>**Confidentiality** | **Član 11.**<br>**Poverljivost** |
| 1. Zyrtari përgjegjës dhe çdo person tjetër i cili pranon apo përpunon raportime në interes publik gjatë kryerjes së detyrës zyrtare duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë brenda ose jashtë institucionit, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveç me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor që lidhet me: | 1. Responsible officer and any other person who accepts or processes reports in the public interest while performing an official duty shall at any time keep confidentiality of the information related to whistleblowing by not revealing or transmitting to third parties within or outside the institution and not using it for other purposes, except with the written consent of the whistleblower or for the fulfillment of a legal obligation that concerns: | 1. Odgovorni službenik i svako drugo lice koje primi ili postupa po prijavi u javnom interesu, u toku vršenja službene dužnosti mora da u svakom trenutku sačuva poverljivost informacija u vezi sa uzbunjivanjem, ne sme da ih prenosi niti saopšti trećem licu unutar ili izvan ustanove, i ne sme da ih koristi u drugu svrhu osim uz pisanu saglasnost uzbunjivača ili za izvršenje neke zakonske obaveze u vezi sa: |
| 1.1.hetimin efektiv të shkeljeve ligjore; | 1.1. the effective investigation of legal violations; | 1.1. efikasnom istragom kršenja zakona; |
| 1.2. parandalimin e rrezikut serioz për sigurinë e shtetit, shëndetin publik, | 1.2. the prevention of serious risk to the | 1.2. sprečavanjem ozbiljnog rizika po bezbednost države, javno zdravlje, javnu |

| | | |
|---|---|---|
| sigurinë publike ose mjedisin; | security of Kosovo, public health or public safety, or the environment; | bezbednost ili životnu sredinu; |
| 1.3. parandalimin e krimit ose ndjekjen penale; | 1.3. the prevention of crime or the prosecution of a criminal offence; | 1.3. suzbijanjem kriminala ili krivičnim gonjenjem; |
| 1.4. domosdoshmërinë e zbulimit në interes publik ose kur një gjë e tillë kërkohet me ligj. | 1.4. the necessity to disclose in public interest or whenever required by law. | 1.4. nužnoću njenog otkrivanja u javnom interesu ili kad je to propisano zakonom. |
| 2. Zyrtari përgjegjës dhe personat tjerë nuk duhet të njoftojnë personin e përmendur në sinjalizim, përveç nëse kërkohet domosdoshmërisht me ligj. | 2. Responsible officer and any other person shall not inform any person mentioned in the whistleblowing, unless otherwise provided by law. | 2. Odgovorni službenik i druga lica ne smeju da obaveste lice pomenuto u uzbunjivanju osim ako to nužno nalaže zakon. |
| 3. Zyrtari përgjegjës duhet të marrë pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit në rast se i kërkohet të japë të dhëna që mund të zbulojnë identitetin e sinjalizuesit tek një autoritet kompetent për veprime që nuk mund të ndërmerren pa e zbuluar identitetin e sinjalizuesit. | 3. Responsible oficial shall obtain the written consent of the whistleblower when he or she is required to provide information that might reveal the identity of the whistleblower to any competent authority for actions that cannot be undertaken without revealing the identity of the whistleblower. | 3. Odgovorni službenik mora da pribavi pisanu saglasnost uzbunjivača u slučaju da se traži da pruži podatke koji mogu da otkriju identitet uzbunjivača nekom nadležnom organu koji ne može da postupan bez otkrivanja identiteta uzbunjivača. |
| 4. Kur është e nevojshme të zbulohet identiteti i një sinjalizuesi gjatë procesit, zyrtari përgjegjës njofton sinjalizuesin për këtë fakt para se t'ia zbulojë identitetin. | 4. When it is necessary to reveal the identity of a whistleblower during the process, the responsible officer shall notify the whistleblower of this fact before revealing his/her identity. | 4. Kad je nužno da se otkrije identitet uzbunjivača u toku postupka, odgovorni službenik obavestiće uzbunjivača o toj činjenici pre nego što mu otkrije identitet. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 12**<br>**Mbrojtja e të dhënave personale të sinjalizuesit** | **Article 12**<br>**Protection of personal data of whistleblowers** | **Član 12.**<br>**Zaštita ličnih podataka uzbunjivača** |
| 1. Të dhënat personale të sinjalizuesit dhe të personave të tjerë të përfshirë në sinjalizim përpunohen vetëm për qëllime të këtij ligji. | 1. The personal data of the whistleblower and other persons involved in whistleblowing are processed only for purposes of this Law. | 1. Lični podaci uzbunjivača i drugih lica umešanih u uzbunjivanje obrađuju se samo u svrhu propisanu ovim zakonom. |
| 2. Zyrtari përgjegjës dhe çdo person tjetër që merr të dhëna personale sipas këtij ligji duhet t'i përpunojë ato në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. | 2. Responsible oficial and any other person receiving personal data under this Law must proces them in accordance with the applicale law on the protection of personal data. | 2. Odgovorni službenik i svako drugo lice koje uzima lične podatke na osnovu ovog zakona mora da ih obradi u skladu sa zakonom o zaštiti ličnih podataka. |
| 3. Nëse gjatë trajtimit të informacionit të parashtruar nga sinjalizuesi, haset në të dhëna personale që nuk janë relevante për rastin që është duke u trajtuar, zyrtari përgjegjës apo autoriteti kompetent nuk mund t'i përpunojë më tutje të dhënat e tilla. | 3. If during handling the information provided by the whistleblower, personal data are encountered that are not relevant to the case being dealt with, the responsible person or the competent authority cannot proceed such data further. | 3. Ako se u toku obrade informacija koje dostavi uzbunjivač uz njih nađu i lični podaci koji nisu relevantni za slučaj koji se obrađuje, odgovorni službenik ili nadležni organ ne može da nastavi da obrađuje takve podatke. |
| **KAPITULLI III**<br>**LLOJET DHE PROCEDURA E SINJALIZIMIT** | **CHAPTER III**<br>**WHISTLEBLOWING TYPES AND PROCEDURE** | **GLAVA III**<br>**VRSTE I POSTUPAK UZBUNJIVANJA** |
| **Neni 13**<br>**Llojet e sinjalizimit** | **Article 13**<br>**Types of whistleblowing** | **Član 13.**<br>**Vrste uzbunjivanja** |
| 1. Sinjalizimi mund të jetë i brendshëm, i jashtëm dhe publik. | 1. Whistleblowing can be internal, external, or public. | 1.Uzbunjivanje može da bude interno, spoljašnje i javno. |
| 2. Raportimi i informacionit te punëdhënësi | 2. Reporting information to the employer is | 2. Prijavljivanje informacije poslodavcu smatra |

| | | |
|---|---|---|
| konsiderohet si sinjalizim i brendshëm. | considered to be internal whistleblowing. | se internim uzbunjivanjem. |
| 3. Raportimi i informacionit tek autoriteti kompetent konsiderohet si sinjalizim i jashtëm. | 3. Reporting information to a competent authority is considered to be external whistleblowing. | 3. Prijavljivanje informacije nadležnom organu smatra se spoljašnjim uzbunjivanjem. |
| 4. Shpalosja e informacionit në media, tek organizatat joqeveritare, përmes internetit, në një mbledhje publike, ose në ndonjë mënyrë tjetër që e bën informacionin publik konsiderohet si sinjalizim publik. | 4. Disclosure of information to the media, non-governmental organizations, through the Internet, at a public meeting, or in any other way that makes information public is considered to be public whistleblowing. | 4. Objavljivanje informacije u medijima, nevladinim organizacijama, putem interneta, na javnom skupu ili na drugi način kojim se informacija obelodanjuje smatra se javnim uzbunjivanjem. |
| **Neni 14**<br>**Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit** | **Article 14**<br>**Form and content of whistleblowing** | **Član 14**<br>**Oblik i sadržaj uzbunjivanja** |
| 1. Sinjalizuesi e paraqet informacionin te zyrtari përgjegjës. | 1. A whistleblower submits the information to the responsible officer. | 1.Uzbunjivač podnosi informaciju odgovornom službeniku. |
| 2. Informata duhet të jetë e kuptueshme dhe duhet të përmbajë të dhënat e personit kundër të cilit paraqitet sinjalizimi si dhe faktet të cilat i disponon sinjalizuesi. | 2. The information must be understandable and must contain the details of the person against whom whistleblowing is presented as well as the facts possessed by the whistleblower. | 2. Informacija mora da bude razumljiva i da sadrži podatke o licu protiv kojeg se vrši uzbunjivanje kao i činjenice kojima raspolaže uzbunjivač. |
| 3. Sinjalizimi mund të paraqitet: | 3. Whistleblowing can be presented: | 3. Uzbunjivanje može da se izvrši: |
| 3.1. me shkrim; | 3.1. in writting; | 3.1. napismeno; |
| 3.2. me postë apo e-mail; dhe | 3.2. by mail or e-mail; and | 3.2. običnom ili elektronskom poštom; i |
| 3.3. gojarisht. | 3.3. verbally. | 3.3. usmeno. |
| 4. Kur informata paraqitet gojarisht, zyrtari përgjegjës e përpilon informatën me shkrim | 4. When the information is presented verbally, the responsible officer compiles a written | 4. Kad se informacije daju usmeno, odgovorni službenik sačinjava pisanu informaciju koju |

| | | |
|---|---|---|
| dhe të njëjtën e nënshkruajnë sinjalizuesi dhe zyrtari përgjegjës. | notice which is signed by the whistleblower and the responsible oficial. | potpisuju uzbunjivač i odgovorni službenik. |
| **Neni 15**<br>**Pranimi dhe evidentimi i sinjalizimit** | **Article 15**<br>**Receiving and recording whistleblowing** | **Član 15**<br>**Prijem i evidentiranje uzbunjivanja** |
| 1. Zyrtari përgjegjës evidenton sinjalizimin e pranuar dhe krijon një regjistër, i cili duhet të përmbajë: | 1. The responsible oficial records the received report and set up a register which must contain: | 1. Odgovorni službenik evidentira primljeno uzbunjivanje i otvara poseban registar koji mora da sadrži: |
| 1.1. datën e pranimit; | 1.1. the date of receipt; | 1.1. datum prijema; |
| 1.2.emrin dhe mbiemrin e sinjalizuesit; | 1.2. the name and surname of the whistleblower; | 1.2. ime i prezime uzbunjivača; |
| 1.3.të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit; | 1.3. the whistleblower’s contact details; | 1.3.podatke o kontaktu sa uzbunjivačem; |
| 1.4. institucionin e sinjalizuesit, dhe | 1.4. the whistleblower's institution, and | 1.4 ustanovu uzbunjivača, i |
| 1.5. përmbajtjen e shkurtër të informatës. | 1.5. a brief information content. | 1.5 kratku sadržinu informacije. |
| 1. Sinjalizuesit i jepet dëshmi për sinjalizimin e parashtruar dhe lista e çdo dokumenti të parashtruar bashkë me të. | 2. The whistleblower shall be provided with attestation of the filed report and a list of any documents filed with it. | 2. Uzbunjivaču se daje dokaz da je podneo informaciju i spisak svih pratećih dokumenata koje je podneo. |
| **Neni 16**<br>**Sinjalizimi i brendshëm** | **Article 16**<br>**Internal whistleblowing** | **Član 16.**<br>**Interno uzbunjivanje** |
| 1. Procedura e brendshme e hetimit administrativ të sinjalizimit iniciohet nga | 1. The internal procedure of administrative investigation of whistleblowing is initiated | 1.Interni postupak upravne istrage uzbunjivanja pokreće se u trenutku prijave |

| | | |
|---|---|---|
| momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar.<br><br>2. Punëdhënësi e njofton sinjalizuesin për pranimin ose refuzimin e sinjalizimit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të sinjalizimit.<br><br>3. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit përfundon sa më shpejt që është e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar, përveç se kur nga rrethanat e rastit kërkohet shtyrja e afatit, e cila nuk mund tw jetw mw e gjatw se dyzetepesë (45) ditë.<br><br>4. Në fazën e hetimit administrativ, zyrtari përgjegjës shqyrton dhe vlerëson pretendimet e ngritura nga sinjalizuesi.<br><br>5. Gjatë fazës së hetimit administrativ, zyrtari përgjegjës mund të kërkojë informacion shtesë dhe dokumente relevante, të urdhërojë inspektime ose të marrë deklaratë nga personat në dijeni për çështjen, si dhe të konsultohet me ekspertë të fushës përkatëse.<br><br>6. Në hetimin administrativ mund të marrë pjesë sinjalizuesi, personi i tretë për të cilin | from the moment of reporting of whistleblowing information.<br><br>2. The employer notifies the whistleblower of the receipt or rejection of whistleblowing report within fifteen (15) days from the date of receipt of the whistleblowing.<br><br>3. The procedure of administrative investigation of whistleblowing shall me completed as soon as possible, but in any case not later than forty five (45) days from the date of submission of whistleblowing, unless a postponement of dealine is required from the circumstances of the case and which can not be longer than forty five days (45).<br><br>4. During the phase of administrative investigation, the responsible officer examines and evaluates the allegations raised by the whistleblower.<br><br>5. During the phase of administrative investigation, the responsible officer might request additional information and relevant documents, order inspections or gather statements from persons who are aware of the case or consult with experts of relevant field.<br><br>6. The whistleblower and any other third person may participate in the administrative | informacije sa uzbunjivanjem.<br><br>2. Poslodavac obaveštava uzbunjivača da li je prijvatio ili odbio uzbunjivanje u roku od petnaest (15) dana od dana prijema uzbunjivanja.<br><br>3. Postupak upravne istrage uzbunjivanja okončava se što pre je moguće, u svakom slučaju ne kasnije od četrdeset pet (45) dana od prijema informacije sa uzbunjivanjem, osim ako od okolnosti slučaja nije potrebno odlaganje postupanja i koje ne može biti duže od četrdeset pet dana (45).<br><br>4. U fazi upravne istrage, odgovorni službenik razmatra i ocenjuje tvrdnje koje je naveo uzbunjivač.<br><br>5. U fazi upravne istrage odgovorni službenik može da traži dodatne informacije i relevantna dokumenta, da naloži inspekciju ili uzme izjave od lica upoznatih sa predmetom, ili da se konsultuje sa stručnjacima iz određene oblasti.<br><br>6. U upravnoj istrazi mogu da učestvuju uzbunjivač, treće lice za koje se veruje da je |

| | | |
|---|---|---|
| besohet se ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara apo posedon dokumentacion relevant. | investigation, when it is believed that he/she is aware of the reported circumstances or possess relevant documents. | upoznato sa okolnostima navedenim u uzbunjivanju ili poseduje relevantnu dokumentaciju. |
| 7. Çdo pale pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe pala: | 7. Each party participating in the administrative investigation is guaranteed a due process, in accordance with the law on the general administrative procedure, and the party: | 7. Svakoj strani učesnici u upravnoj istrazi garantovan je redovan postupak u skladu sa Zakonom o opštem upravnom postupku, tako da strana: |
| 7.1. mund të japë deklaratë me shkrim; | 7.1. may make written statements; | 7.1. može dati pisanu izjavu; |
| 7.2. të paraqesë prova ose opinione; | 7.2. may present evidence or opinions; | 7.2. da podnosi dokaze ili mišljenja; |
| 7.3. mund të konsultohet me dosjen e hetimit; | 7.3. can consult the investigation file; | 7.3. može da razgleda spise istrage; |
| 7.4. ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij. | 7.4. has the right to be heard about his or her claims. | 7.4. ima pravo da bude saslušana u vezi svojih navoda. |
| 8. Punëdhënësi duhet të vendosë në dispozicion të hetimit të dhënat, dokumentacionin dhe provat e zotëruara prej tij. | 8. The employer must make available to the investigation the records, documentation and evidence under his or her possession. | 8. Poslodavac je dužan da za istragu učini dostupnim podatke, dokumentaciju i podatke koji su mu zatraženi. |
| 9. Nëse në përfundim të procesit të hetimit administrativ të sinjalizimit nga punëdhënësi, rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje ligjore sipas ligjit, punëdhënësi vë në dijeni organin kompetent. | 9. If, at the conclusion of the administrative investigation of whistleblowing by the employer, it results that the alleged suspected act or practice constitutes or could constitute a legal violation, the employer notifies the competent authority. | 9. Ako se na kraju postupka upravne istrage po uzbunjivanju unutar poslodavca ispostavi da se sumnjiva radnja ili praksa koji su predmet uzbunjivanja sadrže ili mogu sadržati povredu zakona, poslodavac će o tome da obavesti nadležni organ. |

| | | |
|---|---|---|
